

VENDIM
Nr.160, datë 25.2.2008

PËR KRIJIMIN E NËNKOMISIONIT “PËR REFORMËN NË DREJTËSI”

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe të nenit 19 pika 2 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Konferencës së Kryetarëve,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Pranë Komisionit të Përhershëm për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut krijohet nënkomisioni “Për reformën në drejtësi”.

II. Objekti i veprimtarisë së këtij nënkomisioni është përcaktimi i çështjeve dhe masave që do të përfshihen në Paktin Kombëtar për Drejtësinë, i cili do të miratohet nga Kuvendi i Shqipërisë.

III. Përbërja e nënkomisionit është si më poshtë:

1. Fatos Beja	PD	Kryetar
2. Fatmir Xhafaj	PS	Zëvendëskryetar
3. Ilir Rusmali	PD	Anëtar
4. Aldo Bumçi	PD	“
5. Arben Isaraj	PS	“
6. Besnik Dervishi	PS	“
7. Arjan Madhi	PR	“
8. Spiro Peçi	PBDNJ	“
9. Spartak Braho	LSI	“

IV. Nënkomisioni “Për reformën në drejtësi” do të kryejë këto detyra:

a) Hapja e një dialogu intensiv, për të përcaktuar çështjet që meritojnë të jenë objekt i reformës, me institucionet e sistemit të drejtësisë dhe grupet e interesit, duke kryer seanca dëgjimore me Këshillin e Lartë të Drejtësisë, Gjykatën Kushtetuese. Gjykatën e Lartë, Prokurorinë e Përgjithshme, Shkollën e Magjistraturës, Avokatin e Popullit, Policinë e Shtetit, Fakultetin Juridik të Universitetit të Tiranës, Dhomën Kombëtare të Avokatisë, Komitetin Shqiptar të Helsinkit, shoqata, organizata të shoqërisë civile, universitete private etj.

b) Ngritja e grupit të ekspertëve që do të asistojnë procesin e reformës në drejtësi pranë Kuvendit të Shqipërisë.

c) Sigurimi i një mbështetjeje ndërkombëtare të grupit të ekspertëve, nëpërmjet misionëve të ekspertizës përfaqësuese të BE-së (Euralius), SHBA-së (OPDAT) dhe OSBE-së (Prezenca në Tiranë), për garantimin e implementimit të standardeve komunitare në këtë proces.

ç) Hapja e një forumi *on-line* në faqen zyrtare të Kuvendit të Shqipërisë, me qëllim përfitim të opinionëve në lidhje me çështjet e identifikuara për t’u trajtuar në Paktin Kombëtar të Drejtësisë.

d) Konsultimi me Këshillin e Ministrave për mundësitë e realizimit në kohë dhe mbështetjen buxhetore të nevojshme për realizimin e reformës në drejtësi.

V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)